



**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Zyra e Prokurimit - Komuna Junik
Datë: 21.09.2020**

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, paragrafi 6 dhe 10, pika 10.1 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 08.09.2020, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim (ankesës) të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P Vlora, Prishtinë të datës: 11.09.2020, lidhur me tenderin “**Furnizim me klima për objektin e QKMF-së**”, me numër të brendshëm të prokurimit: 636-20-016-136 dhe me numër të prokurimit: 636-20-4158-1-3-6, të shpallur me dt. 06.08.2020, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë kërkesa për ri-shqyrtim (ankesa) nga Operatori Ekonomik N.T.P Vlora, e parashtruar me datën: 11.09.2020, lidhur me tenderin: “**Furnizim me klima për objektin e QKMF-së**”, me numër të brendshëm të prokurimit: 636-20-016-136 dhe me numër të prokurimit: 636-20-4158-1-3-6.
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna Junik i datës: 08.09.2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas ditës së nënshkrimit të këtij vendimi.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, shqyrtoi kërkesën për ri-shqyrtim të datës: 11.09.2020, të pranuar përmes sistemit elektronik E-Prokurimi e parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P Vlora duke analizuar të gjitha faktet e ofruara nga operatori ekonomik në fjalë dhe bazuar në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar për këto arsye:

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me klima për objektin e QKMF-së në web faqen zyrtare të E-Prokurimit.

Provë: Njoftimi i Publikuar në web faqen zyrtare të E- Prokurimit

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datën: 04.09.2020, ku përmes këtij njoftimi AK ju shpërblen me kontratë, po të njëjtën ditë AK ka pranuar njoftimin nga përfaqësuesi i Kolegjiumit të Prokurimit që të mos shpërblehet me kontratë asnjë prej OE që janë diskualifikuar nga aktivitetet e prokurimit për një periudhë prej 6 muaj. AK me dt: 04.09.2020 e ka bërë Njoftimin mbi Vendimin e AK mirëpo nuk e ka bërë Njoftimin për Dhënien e Kontratës që nënkupton se nuk kemi të drejtë të nënshkruajmë kontratë me juve pasi që OSHP – ja ju ka diskualifikuar për një periudhë prej 6 muaj nga aktivitetet e prokurimit. Prandaj, bazuar në njoftimin e Kolegjiumit dhe Vendimin e OSHP- së me nr. 523-20, të datës: 04.09.2020, AK- Komuna Junik ka anuluar Njoftimin mbi vendimin e AK të dt: 04.09.2020 dhe ka kthyer lëndën në ri-vlerësim.

Pas rivlerësimit me datën: 08.09.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me klima për objektin e QKMF- së në web faqen zyrtare të E-Prokurimit.

Provë: Njoftimi i Publikuar në web faqen zyrtare të E- Prokurimit.

Me datën: 11.09.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, ka pranuar kërkesën për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe menjëherë ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.

Provë: Njoftim për pezullim

Në vazhdim ashtu siç parashihet në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik jep përgjigje me shkrim parashtruesit të ankesës, operatorit ekonomik N.T.P.Vlora, Prishtinë, lidhur me pretendimet e bëra në kërkesën për ri-shqyrtim (ankesën) :

Pas njoftimit dhe Vendimit të OSHP-së me nr. rendor 523/20, të pranuar me datën: 04.09.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, ka kthyer lëndën në ri- vlerësim dhe ka vepruar konform këtij Vendimi 523/20.

Provë: Vendimi 523/20

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka ri- vlerësuar këtë aktivitet të prokurimit duke u bazuar në paragrafin II, të Vendimit të OSHP- së me numër rendor 523/20, ku paragrafi II i këtij vendimi operatorin ekonomik N.T.P Vlora e diskualifikon nga aktivitetet e prokurimit prej dt: 03.09.2020 deri me dt: 02.03.2021, që do të thotë se AK- Komuna Junik ka vepruar konform njoftimit të pranuar me dt: 04.09.2020 nga përfaqësuesi i Kolegjiut të Prokurimit që Autoritetet Kontraktuese nuk duhet të shpallin fitues operatorët ekonomik që janë të diskualifikuar nga aktivitetet e prokurimit për një periudhë të caktuar kohore.

Andaj, ankesa juaj kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik hidhet poshtë si e pabazuar përderisa Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka pranuar Njoftimin nga OSHP- ia për diskualifikimin tuaj nga aktivitetet e prokurimit për periudhën e lartëcekur si dhe interpretimi i pretenduar nga ana juaj nuk është vendosur në sistemin elektronik si dhe nuk e keni të bashkangjitur dëshminë në kërkesën për rishqyrtim siq keni pretenduar.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e paraqitura, AK nuk ka bërë asnjë prej shkelje të neneve të pretenduar nga ana juaj sepse ne si AK nuk mund të dalim mbi vendimet e një organi më të lartë siq është OSHP- ia (Vendimet e OSHP- së), konkretisht nuk mund të veprojmë ndryshe nga Vendimi i OSHP- së, ku me atë ju ndalohet pjesëmarrja ne aktivitetet e prokurimit për periudhën e caktuar kohore.

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik bazuar në nenin 4, paragrafin 1.26 të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi si dhe duke marrë në konsideratë Vendimin me numër rendor 523/20 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të pranuar me dt: 04.09.2020 refuzon kërkesën tuaj për rishqyrtimin e lëndës në fjalë.

Provë: Vendimi i OSHP 523/20

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroi ankesë konform Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 109 pika 2 në OSHP.

Aktvendimi ti dorëzohet:

- Zyrës së Prokurimit
- OE, N.T.P Vlora
- Arkivit të Komunës

U.D.Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit:

